



NGJALLJA

Nr. 1 (144) Viti IX i botimit

JANAR 2005

Çmimi 10 lekë

Mesazhi i Krishtlindjeve 2004 (Dashuria e Perëndisë mishërohet)

+Anastasi

Kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë

Klerit dhe besimtarëve shpresëtarë Orthodhoksë,
Bij të shtrenjtë më Zotin,

*“Perëndia është dashuri. Kështu u shfaq dashuria e Perëndisë tek ne:
Perëndia dërgoi birin e tij të vetëmlindur në botë, që ne të rrojmë nëpërmjet tij” (1 Jn. 4:8-9)*

E vërteta që shpall me ngulm besimi i krishterë është se “Perëndia është dashuri”. Këtë realitet mahnitës thekson në mënyrë gazmore e kremtja e sotme. Krishtlindjet na risjellin në mënyrë solemne në mendje dhe ndërgjegje shprehjen tronditëse të dashurisë së Perëndisë, që e përmbledh vargu i Ungjillit: “Kështu u shfaq dashuria e Perëndisë tek ne: Perëndia dërgoi birin e tij të vetëmlindur në botë, që ne të rrojmë nëpërmjet Tij”.

Me hyrjen e Fjalës Hyjnore në udhën historike të njerëzimit, dashuria e Perëndisë zbulohet në mënyrë më të fortë: “ajo mi-

shërohet”. Me Trupëzimin e Tij, i Biri i Perëndisë, merr tërë natyrën njerëzore, në tërëqenien e saj shpirtërore dhe materiale. E rikrijon atë. Ky fakt mbetet rrënja e zbulësës së krishterë, që ushqen çdo propozim dhe vlerë tjetër të krishterë.

Kjo shfaqje konkrete e dashurisë së Perëndisë me anën e “mishërimit”, bën dallimin përcak-

tues të besimit të krishterë: Perëndia, Krijuesi dhe Zoti i gjithësisë nuk është një veprim, urtësi dhe fuqi abstrakte, diçka që mendja njerëzore mund të dyshonte dhe t’i afrohej me aftësitë mendore të trurit. Është Perëndi personal plot dashuri, që i zbulohet njeriut dhe ndodhet në marrëdhënie të vazhdueshme me të. Një marrëdhënie që bëhet e ndjeshme nga e

gjithë qenia njerëzore. Perëndia i dashurisë nuk e braktisi botën, e cila gjen vdekjen nga egoizmi dhe urrejtja. Ai lëviz midis nesh, brenda qyteteve tona të zhurmshme, në shkretëtirën e vetmisë sonë, duke dhënë fuqi dashurie, duke falur kuptim dhe plotësim në jetë.

Kjo dashuri e Perëndisë mbetet përjetësisht e dukshme në Trupin mistik të Krishtit, që është “Kisha e Perëndisë së gjallë, shtyllë dhe mbështetje e së vërtetës (1 Tim. 3:15). Misioni bazë i Kishës së

(Vijon në faqen 6)

Me hyrjen e Fjalës Hyjnore në udhën historike të njerëzimit, dashuria e Perëndisë zbulohet në mënyrë më të fortë: “ajo mishërohet”. Ky fakt mbetet rrënja e zbulësës së krishterë, që ushqen çdo propozim dhe vlerë tjetër të krishterë.

Lexoni në faqet 7-8,12:

Besimtarët Orthodhoksë kremtojnë Krishtlindjet dhe Ujin e Bekuar

Tiranë



Shërbesa e Ujit të Bekuar në Tiranë

Berat



Besimtarët e mbledhur për Ujin e Bekuar në Berat

2 përgjigje, të pabotuara, drejtuar gazetës "Shekulli"

Kohët e fundit gazeta "Shekulli" ka botuar dy artikuj tendenciozë, ku preket figura e Kryepiskopit Anastas, të cilët në thelb kundërshtojnë njëri-tjetrin. Në kundërshtim me detyrimin ligjor dhe etikën gazetareske asnjë nga përgjigjet nuk u botua.

"Kaloi koha e ksenofobisë dhe arriti koha e mirënjohjes dhe falënderimit..."

Kryeredaktorit të gazetës "Shekulli"

Kam lexuar me vëmendje, por me vonesë artikullin "Mungesa e pajustificuar", botuar në gazetën "Shekulli", të datës 15 dhjetor 2004, i cili kërkon një sqarim. Autori, me një mjeshtëri të dukshme, ka përpiluar disa pika të ndërthurura, por aspak të lidhura me kritikën e tij kryesore. Me këtë letër nuk do të analizoj të gjitha detajet e artikullit.

Kryepiskopi Anastas u largua nga Shqipëria për në Athinë, ku më 1 dhjetor u qerua për të rregulluar një problem shëndetësor. Gjatë qëndrimit të tij në spital ai u vizitua nga Ambasadori i Shqipërisë në Greqi së bashku me stafin e tij, të cilët i çuan Kryepiskopit një buqetë me lule dhe urimet në emër të qeverisë për mbarësi dhe shëndet të plotë.

I ngarkuar nga Kryepiskopi, si përfaqësues i tij dhe i Kishës në

Samitin e Evropës Juglindore, i mbajtur në Tiranë i përmbusha të gjitha detyrat.

Me kulturën e tij të gjerë dhe me emrin e tij të njohur në mbarë botën Kryepiskopi Anastas përdor dinjitetin e tij personal dhe të shumanshëm për nder të Shqipërisë dhe për mbarëvajtjen e popullit shqiptar. Pra edhe koha që të mërrapriten kritikët e trilluara duke mos pranuar fjalët, ndjenjat dhe veprat e tij shqiptare. Kaloi koha e ksenofobisë dhe arriti koha e mirënjohjes dhe falënderimit për personat si Kryepiskopi Anastas, të cilët i bëjnë shërbime të kushtueshme vendit.

*Me nderime,
+ Episkop Ilia
i Dioqezës Orthodhokse
Shqiptare të Amerikës dhe
Drejtor i Akademisë Teologjike
"Ngjallja e Krishtit" në Durrës*

"Shëndeti i Kryepiskopit është shumë mirë..."

Në lidhje me artikullin e botuar në numrin e sotëm të gazetës suaj "Janullatosi i sëmurë, Kishën e drejtojnë mëkëmbësit e tij", sqarohet se artikulli ka shtrembërimet e të vërtetës dhe të prononcimit të bërë nga ana jonë gazetares Lindita Çela.

Së pari, gazetares iu konfirmua se shëndeti i Kryepiskopit është shumë mirë, pas një operacioni të bërë dhe se mbas kontrolleve mjekësore do të kthehet shpejt. Kështu që titulli për "gjendjen e rëndë", apo afirmimet për "gjendjen kritike shëndetësore" janë thjesht spekulative dhe të pavërteta.

Kryepiskopi nuk ka qenë në Shqipëri vetëm gjatë një periudhe të muajit dhjetor, por për Krishtlindje ai i uroi besimtarët dhe gjithë popullin nëpërmjet ekraneve televizive. Në fund të dhjetorit Kryepiskopi Anastas ndodhej në Tiranë dhe drejtoi Liturgjitë Hyjnore të datave 1 dhe 2 janar 2005, si dhe mbledhjen e Sinodit të Shenjtë të datës

3 janar, duke u larguar më pas për disa kontrolle rutine mjekësore.

Së dyti, mungesa e sinqeritetit në pyetjet e bëra dhe përdorimi i informacioneve fragmentare, e bëjnë gazetaren të shkruante me mosnjohje të plotë për "mëkëmbësia". Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë ka një hierarki të qartë dhe të plotë, me në krye Kryepiskopin Anastas, i cili për asnjë çast nuk është shkëputur nga drejtimi i saj. Organi më i lartë i saj është Sinodi i Shenjtë, i përbërë nga Kryepiskopi Anastas, Mitropoliti i Beratit Ignati, Mitropoliti i Korçës Joani, Imzot Ilia dhe nga Kryesekretari, Protopresviteri Jani Trebicka. Të gjitha detyrat e tjera të drejtimit janë administrative dhe nuk zëvendësojnë funksionet e Kryepiskopit dhe të anëtarëve të Sinodit të Shenjtë. Fakti se At Jani Trebicka kryesoi ceremoninë e Ujit të Bekuar në Tiranë (për të cilën u interesua gazetarja), nuk do të thotë se ai drejton në vend të Kryepiskopit (të gjitha shërbesat drejtohen domosdoshmërisht nga një klerik).

Ndaj duke vlerësuar interesin tuaj të veçantë për shëndetin e Kryepiskopit Anastas, përsërisim se ngjyrat alarmante që i janë dhënë shkrimit, janë thjesht spekulative. Ashtu siç ishte edhe shkrimi "Mungesa e pajustificuar" (15 dhjetor 2004), i Mentor Nazarkos. Kodi etik i gazetarit që është varur në mjediset e gazetës suaj duhet të vlejë në të gjitha rastet dhe për të gjithë dhe jo në mënyrë selektive të dyshimtë.

Shpresojmë se këtë herë dhe sipas standardeve evropiane, ky reagim do të botohet dhe nuk do të përsëritet ajo që ndodhi me përgjigjen e Episkopit Ilia për artikullin e z. Nazarko, të cilën e latë në heshtje.

*Zyra e Shtypit
e Kishës Orthodhokse
Autoqefale të Shqipërisë*

Dëmtohet kryqi në Fikas

Në datën 9 janar u konstatua se ishte tentuar prishja e kryqit orthodhoks pranë fshatit Fikas. Autorët e këtij akti të shëmtuar ishin përpjekur ta prisnin me oksigjen, por nuk ia kishin arritur qëllimit. Kjo i revoltoi shumë banorët e fshatit dhe gjithë besimtarët orthodhoksë të zonës, sepse ishte një fyerje dhe përdhosje ndaj besimit të tyre, ndaj morën masa që të mos lejohet që ky veprim të përsëritej.

Megjithëse kryqi është vendosur në një fshat orthodhoks dhe me leje të rregullt nga komuna, nga ana e drejtuesve aktualë të besimit mysliman në Elbasan ka pasur presione për ta hequr, me pretendimin se kjo trevë nuk i përket besimit të krishterë. Së pari, zona ku është ngritur kryqi është ndër ato me tradita më të hershme e të thella në besimin orthodhoks, që dësh-

mohet edhe nga Manastiri i shenjtë njëmijëvjeçar i Shën Joan Vladimirit dhe kishat e shumta, shumica e të cilave u shkatërruan gjatë regjimit ateist, por edhe më parë. Së dyti, besimtarët orthodhoksë nuk kanë për t'i kërkuar leje kujt për mënyrën se si e ushtrojnë besimin e tyre dhe për të shfaqur simbolet e besimit të tyre. Komunitetet e

tjera i kanë ngritur objektet e kultit dhe simbolet e tyre atje ku kanë dashur dhe si kanë dashur dhe besimtarët orthodhoksë nuk kanë ndërhyrë asnjëherë në këtë të drejtë të tyre. Po kështu, nuk do lejohet askënd që t'i çënojë. Ata nuk janë raja të trembur nga beu, por qytetarë me të drejta të barabarta me të gjithë të tjerët.



*Kryqi
orthodhoks
i ngritur pranë
fshatit Fikas,
me nismën e vetë
banorëve, atje
ku më parë
ngriheshin
disa kisha
orthodhokse, sot
të shkatërruara.*

Festa çënohet nga vjedhje e përdhosje kishash

Periodha e krentimeve të fundvitit përkoi edhe në një riakutizim të sëmundjes së vjedhjes e dëntimit të kishave. Lista e tyre kohët e fundit vjen duke u shtuar gjithmonë e më tepër, ndërsa nga organet e rendit zbulimi i autorëve vazhdon të qëndrojë tek zeroja. Kjo dukuri vazhdon të bëhet gjithmonë e më shqetësuese, ndërsa impenjimi i autoriteteve shtetërore përgjegjëse vazhdon të jetë i përgjumur dhe ineffikas, për të mos thënë indiferent apo diçka më shumë.

Përsëritet e stërpërsëritet se kemi të bëjmë vetëm me krime ordinere, me veprime pa lidhje midis tyre, apo me njerëz që problemet e varfërisë së përditshme kërkojnë t'i zgjidhin në rrugën e kimit. Por, a është vërtet kështu? Janë disa fakte kokëforta, të cilat të shtyjnë që të nxjerrësh edhe të tjera përfundime, të formulosh të tjera hipoteza.

Së pari është intensiteti i tyre. Në një periudhë të shkurtër kanë ndodhur vjedhje të shumta në një zonë të caktuar. Kështu, në Mitropolinë e Gjirokastrës, në zonën e Sarandës, është arritur të shpërthejnë edhe dhjetë kisha brenda një nate, në të Korçës brenda një periudhe të shkurtër u cënuan 15 kisha. Janë disa raste kur brenda një nate vidhen 3-4 kisha të një zone.

Së dyti, është shtrirja gjeografike. Epidemia ka prekur të gjitha dioqezat e Kishës sonë. Ka pasur vjedhje intensive në Sarandë, në Gjirokastrë, në Përmet, në Ersekë, në Korçë, në Elbasan, në Durrës, në zonën e Myzeqesë, në Patos, në Vlorë, në zonën e Bregdetit etj.

Së treti, është paaftësia e policisë për të mbrojtur Komunitetin Orthodhoks nga ky sulm banditesk ndaj objekteve të tij. Megjithë përmasat dhe spektakolaritetin e këtyre akteve (10 kisha në një natë kërkojnë njerëz dhe mjete), organet e rendit kanë qenë duke fjetur gjumë ose në ndonjë anë tjetër dhe nuk kanë gjetur dot asnjë gjurmë

që t'i çonin tek autorët e jo më që t'ia dorëzojnë ata drejtësisë. Kjo krijon tek besimtarët një klimë pasigurie, që është mbase edhe qëllimi i shumë akteve të tilla. Sepse nuk ka si shpjegohet që ato shtohen në çaste krizash e problemesh. Kështu p.sh. pas presioneve për të hequr kryqin në fshatin Xarë dhe tentativës së disa segmenteve të caktuara shtetërore për ta hedhur në erë me tritol, që u shoqëruan edhe me një pasqyrim të shtrembëruar, të njëanshëm dhe acarues në mediat e ndryshme, në atë zonë ndodhën edhe një varg vjedhjesh e grabitjesh e deri tek dhunimi i kampingut të rinisë orthodhokse pranë Manastirit të Shën Gjergjit. Është vështirë të mos krijosh një

lidhje midis tyre, ashtu siç janë të papranueshme tentativat e disa qarqeve politike për të mbajtur Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë peng të marrëdhënieve shqiptaro-greke, duke kryer kështu një veprim jo vetëm të dënueshëm por edhe antikombëtar. Gjithashtu, është e vështirë të pranohet se hajdutët preferokan më shumë objektet orthodhokse të kultit dhe më pak ato të besimeve të tjera, sepse aktet kriminale ndaj objekteve të komuniteteve të tjera janë shumë herë më të vogla.

Shqetësues është edhe fakti se organet e rendit, ndërsa kanë dështuar sistematikisht të gjejnë dhunuesit e kishave tona, tregohen shumë të interesuar të mbulojnë rastet

më flagrante ose t'i minimizojnë ato. Kështu ndodhi me shishet me lëndë djegëse që u hodhën në kishën "Lindja e Krishtit" në Shkodër apo me ngjarjen e Xarrës dhe me letrat kërcënuese për ndërtuesin e kryqit dhe kryetarin e komunës etj.

Dhe së fundi, autoritetet shtetërore, organet e rendit, forcat politike dhe të gjithë duhet të dinë se cënimi i objekteve të kultit nuk është vetëm vjedhje e dhuratave të besimtarëve, por edhe prekje e besimit, fyerje dhe përdhosje e vendit të shenjtë, që krijon ndjenja negative dhe prish bashkëjetesën fetare. Janë akte që më shumë se të tashmen çënojnë të ardhmen.

Th.Dh.

Kisha e Patosit u vodh dhe u përdhos natën e Krishtlindjeve

Natën e Krishtlindjeve, ndërsa besimtarët përgatiteshin të festonin me madhësi këtë të krenar të shënuar, persona ende të paidentifikuar shpërthyen tri dyer të kishës "Ngritja e Kryqit" në Patos. Ata vodhën arkën e kishës, katër ikona dhe disa qerasje të përgatitura për pritjen e autoriteteve dhe të gjithë atyre që do të uronin besimtarët pas Liturgjisë Hyjnore. Por autorët e këtij gjesti të shënuar nuk u mjaftuan me kaq, ata kishin prishur mjedisin e kishës duke derdhur vajin e shërbesave, pëmbysur enët e shenjta etj. Kjo përdhosje

dëshmon se përtej një vjedhjeje të thjeshtë, momenti i aktit të rëndë dhe kjo mënyrë veprimi dëshmon një tentativë për të përcjellë një

mesazh urrejtjeje dhe përçarjeje, në kundërshtim me mesazhin e paqes që sillte Krishti i sapolindur.

Koresp. i "Ngjalljes"



Vjedhje ditën e festës në Mitropolinë e Gjirokastrës

Më flagranta prej tyre ishte grabitja mbrëmjen e së premtes, para Krishtlindjeve e kishës së Gjirokastrës "Metamorfoza e Shpëtimtarit". Kjo u bë ndërsa pritej që të nesërmen në mëngjes të merrte pjesë në Liturgjinë Hyjnore vetë Presidenti i Republikës. Ndaj, një ngjarje e tillë, kur dihet se ç'masa merren në raste të tilla, tregon në rastin më të mirë papërgjegjshmë-

rinë dhe paaftësinë e organeve të rendit. Sepse ndryshe do ishte edhe një mesazh shqetësues për bashkëjetesën fetare. Po atë natë u vodh edhe kisha e Kryeengjëjve në Goranxi.

Natën e Krishtlindjeve pati edhe një sërë vjedhjesh në kishat e Bregdetit: "Shën Dhimitri" në Nivicë, "Shën Vasili" në fshatin Shën Vasil, e "Gjithë Shenjtorëve" dhe "Shën Marina" në Himarë, si

dhe manastiri "Shën Dhimitri" në Qeparo.

Edhe janari ka nisur me vjedhje. Kështu më datë 14 u grabit Manastiri i Profetit Ilia në rrethin e Delvinës. "Grabitësit" nuk janë mjaftuar me të hollat dhe ikonat por kanë shkukur nga oborri në mënyrë vandale shumë rrënjë ullinj e agrume.

Koresp. i "Ngjalljes"

Lista e vjedhjeve të bëra kohët e fundit ndaj kishave orthodhokse

Mitropolia e Tiranës

- 1 - Eshtë vjedhur në mënyrë të përsëritur kisha e Shën Pavlit në Durrës.
- 2 - Eshtë vjedhur kisha e Shën Kollit dhe kopshti i fëmijëve në Elbasan (4 nëntor).
- 3 - Hedhja e dy shisheve me lëndë djegëse në derën e kishës "Lindja e Krishtit" në Shkodër.
- 4 - Tentativa për të shkatërruar kryqin pranë fshatit Fikas.

Mitropolia e Beratit

- 1 - Vjedhur në mënyrë të përsëritur kisha e Shën Gjergjit në Libofshë.
- 2 - Kisha e Karavastasë.
- 3 - Kisha e Daullasit.
- 4 - Kisha e Shën Gjergjit, Fier.
- 5 - Kisha "Ngritja e Kryqit", Patos (duke gdhirë 25 dhjetor).
- 6 - Kishat e Bestrovës, Nartës dhe Zvernecit (periudhën e Krishtlindjeve).

Mitropolia e Korçës

- 1 - Katedralja "Ngjallja e Krishtit", Korçë (8 nëntor).
- 2 - Kisha e Shën Thanasit, Voskopojë.
- 3 - Kisha e Shën Gjergjit, Ersekë (në mënyrë të përsëritur, 24 shtator dhe 9 nëntor).
- 4 - Kisha e Shën Ilisë, Korçë (8 nëntor).
- 5 - Kisha e Shën Thanasit, Korçë.
- 6 - Katedralja "Ngjallja e Krishtit", Pogradec.
- 7 - Brenda tre muajve (gusht tetor '04) janë vjedhur me thyerje 15 kisha.
- 8 - Kisha e Leskovikut.

Mitropolia e Gjirokastrës

- 1 - Kisha e Këlcyrës (10 nëntor).
- 2 - Kisha e Leusës (10 nëntor).
- 3 - Kisha e Shën e Premtes dhe ajo Shën Kollit në qytetin e Përmetit (10 nëntor).
- 4 - Shën Gjergji, Stërmbec (10 nëntor).
- 5 - Në kryqin e Xarrës vendoset tritol.
- 6 - Kisha e Bularatit, Gjirokastrë (28 shtator).
- 7 - Thyerja e rreth 10 kishave brenda një nate në zonën e Sarandës, si Manastiri i Shën Gjergjit, kisha e Çukës (20 shtator) etj.
- 8 - Vandalizmi ndaj kampingut të të rinjve orthodhoksë pranë manastirit të Shën Gjergjit, Çukë (27 shtator) etj.
- 9 - Duke u gdhirë Krishtlindjet u grabit për herë të dytë me thyerje Kisha "Metamorfoza e Krishtit" në Gjirokastrë dhe ajo e Kryengjësive në Goranxi.
- 10 - Natën e Krishtlindjeve janë vjedhur edhe disa kisha në zonën e Bregdetit: Shën Dhimitri në Nivicë, Shën Vasili në Shën Vasil, Gjithë Shenjtorët dhe Shën Marina, Himarë, Manastiri i Shën Dhimitrit në Qeparo.
- 11 - Kisha të tjera të vjedhura në muajt e fundit të vitit 2004: Shën Kozmai, Çarshovë, Shën Nikolla, Vanistër, Shën Harallamabi, Sarandë, Ungjillëzimi, Delvinë, Shën Nikolla, Xarrë, Shën Parashqevia, Terihat, Shën Nikolla, Jorgucat....
- 12 - 14 janar 2005 grabitet Manastiri i Profetit Ilia.

Në vitet e mbretërisë së Aleksit të Komninoit, i cili e mori pushtetin pas Votianitit, u krijua një kontradiktë midis grupeve të inteligjentëve dhe atyre që jetonin në virtyt, pasi disa ngrinin lart figurën e Shën Vasilit duke thënë se kjo figurë shpreh ide të larta, se ai studioi natyrën e gjërave, se në virtyt shumë pak ndryshon nga engjëjt, se nuk fal dosido, dhe se morali i tij është tepër i thellë dhe jo i dheshëm, duke ulur kështu figurën e të shenjtit Gojartë, i cili sipas tyre është krejt i kundërt dhe fal lehtë.

Të tjerë ngrinin lart figurën e Shën Gojartit, duke thënë se ai është më njerëzor në mësimdhënien e tij, dhe se duke iu bërë thirrje njerëzve me fjalën e tij të thjeshtë i udhëheq ata në pendim. Për shkak të predikimeve të tij fjalëmbra dhe analizimit me hollësi të koncepteve e vinin mbi Shën Vasilin dhe Shën Grigor Theologun.

Të tjerë simpatizonin Theologun Grigor, për thjeshtësinë e tij,

"U kujdesëm gjithmonë dhe kujdesemi vazdimisht për të udhëhequr botën në bashkim"

për oratorinë e tij, për fjalën e tij të fuqishme, fjalorin e tij të pasur, duke konsideruar kështu se ai ua kalonte gjithë të shquarve në filozofinë, kulturën dhe gjuhën greke si dhe në thelogji, ndaj fitorja i përkiste atij dhe kështu ngrinin lart figurën e tij. Kjo solli si rezultat përçarjen e besimtarëve, të cilët u ndanë në grupe që u quajtën Ioanitë ("tifoze" të Shën Joanit). Vasilitë ("tifoze" të Shën Vasilit) dhe Grigoritë ("tifoze" të Shën Grigorit).

Ndërkohë që bëheshin diskutime dhe kundërshtime për emrat dhe arsyet e sipërpërmendura të Tre Etërit e Mëdhenj iu shfaqën (jo në gjumë), herë secili më vete dhe herë të tre bashkë, episkopit Joan të qytetit të Evhaitit, i cili ishte njeri shumë i ditur dhe zotëronte shumë mirë filozofinë, kulturën dhe gjuhën greke (siç duket dhe nga shkrimet e tij), dhe që kishte

arritur në kulmin e virtyteve, dhe me një gojë i thonë:

"Ne, siç e shikon, jemi një shpirt pranë Perëndisë dhe asgjë nuk na ndan dhe nuk na sjell në armiqësi me njëri-tjetrin; secili prej nesh, në epokën e tij shkruajti mësim për shpëtimin e njerëzve, duke qenë i ndriçuar nga Shpirti Hyjnor, dhe ne publikuam ato mësim që na u shfaqën prej Tij. Midis nesh nuk ekziston as "i parë" as "i dytë". Prandaj ngrihu menjëherë dhe jepi porosi atyre që bëjnë polemika për ne, të mos na ndajnë, sepse ne edhe kur jetonim në botë edhe kur ikëm prej saj u kujdesëm gjithmonë dhe kujdesemi vazdimisht për të udhëhequr botën në bashkim. Akoma më tepër, bashkoji festat tona në një ditë dhe kështu të festohemi që tani e tutje, ashtu sikundër dhe ne jemi një pranë Perëndisë. Ose ne do të shpejtojmë t'u vemë në ndihmë

gjithë atyre që kryejnë kujtimin tonë, sepse mund të ndërmjetojmë tek Perëndia."

Këto pra thanë dhe u panë të ngjiten përsëri në qiell të veshur me ndriçim të pamasë dhe duke iu drejtuar njëri-tjetrit me emër.

Atëherë i shënjtë episkop, Joani i Evhaitit, bëri ashtu si e këshilluan të Tre Shënjtorët duke qetësuar kështu turmat e njerëzve që hareshin midis tyre (pasi të gjithë e njihnin famën e tij si njeri i virtytshëm). Ky pra ia dorëzoi këtë festë Kishës që të festohet sipas dëshirës së Perëndisë. Por vini re urtësinë e këtij burri të shenjtë. Meqenëse në muajin janar festohen të Tre Shenjtorët, më 1 Janar Shën Vasili, më 25 Janar Shën Grigor Theologu dhe më 27 Janar Shën Joan Gojarti (transferimi i lipsanit), i bashkoi të tre që të festohen në datën 30 Janar duke i stolitur me Kanone, Tropare dhe lavdërime, ashtu siç u ka hije.

*Nga Sinaksari i së kremtes
Përktheu nga greqishtja:
A. Filip*

Rruga e lirisë dhe gëzimi i Krishtlindjeve

Me këtë temë u zhvillua Konferenca e Studentëve Orthodhoksë në Manastirin e Shën Vlashit, në dhjetor 2004. Rreth 150 të rinj morën pjesë në këtë takim të madh dhe tradicional, duke u aktivizuar në shërbesat fetare, bisedat biblike dhe diskutimet në grup, të cilat ishin pjesa më e rëndësishme dhe karakteristike e këtij aktiviteti.

Pas akomodimit në konviktin e Akademisë Teologjike “Ngjallja e Krishtit”, studentët morën pjesë në Shërbesën e Paraklisit dhe pas saj në referatin e shumëpritur të të ftuarit kryesor të konferencës, Mitropolitit të Korçës, Hirësi Joanit. Për më shumë se një orë, ai foli rreth temës “Rruga drejt lirisë”.

“Liria e thellë e njeriut është liria e brendshme ashtu sikurse qëllimi kyç i njeriut nuk është thjesht të jetuarit e disa viteve. Këto vite janë përgatitje për diçka tjetër, për udhëtimin tonë drejt përjetësisë. Të gjitha ndalesat, dhe “mos”-et pothuajse nuk respektohen shpeshherë në emër të lirisë. Faktikisht këto nuk e bëjnë njeriun të lirë, sepse sa më shumë ai i kundërshton ndalesat aq më tepër bëhet i robëruar. Kufizimet nuk i ishin dhënë njeriut për ta penguar lirinë e tij, por për ta zhvilluar dhe plotësuar lirinë e tij. Nuk mund të jesh dot i lirë, nëse nuk do të kesh përgjegjësinë e lirisë. Çdo njeri që do të mundohet të bëjë çfarë të dojë nuk do të jetë i lirë. Në rrugën drejt lirisë është e pamundur që të kalohet pa këto kufizime. Unë do të isha i pari që do të doja një rrugë drejt lirisë pa këto kufizime, por është e pamundur. Natyra jonë është e deformuar dhe kthimi në gjendje të drejtë bëhet me dhimbje. Sa më tepër që t’i afrohet njeriu Zotit, aq më i lirë do të bëhet dhe aq më tepër gëzim do të ndiejë në shpirtin e tij” - theksoi Hirësi Joani gjatë referatit.

Më pas studentët e pranishëm në këtë konferencë u ndanë nëpër grupe, duke u njohur me njëri-tjetrit nëpërmjet prezantimit dysh, që u praktikua për herë të parë në një aktivitet të tillë. Studentët, pasi kishin pyetur rreth njëri-tjetrit, u prezantuan para grupit duke krijuar

një atmosferë të ngrohtë miqësore. Më tej, ata treguan një histori para të gjitha grupeve rreth një fotografie, të cilën duhet ta interpretonin si një ngjarje që kishte pasojë në jetën e personit ose ambientit rreth tij dhe si mund të reflektojmë ne si të krishterë për t’i ndihmuar këta njerëz në nevojë.

Ditën tjetër u zhvillua një diskutim biblik, në të cilin vetë studentët treguan për mënyrën se si i prisnin Krishtlindjet, reflektuan për disa nga të veçantat e vitit 2004 në jetën e tyre dhe si e presin Vitin e Ri 2005.

Një program argëtues me këngë

e valle popullore shqiptare në amfiteatrin e konferencave dhe aktiviteteve sportive të Manastirit të Shën Vlashit do ta gjallëronte edhe më shumë veprimtarinë.

Në mbrëmje, misionari amerikan, pedagog i Akademisë Teologjike, Nathan Hoppe, foli për gëzimin e Krishtlindjeve.

“Me ardhjen e Krishtit shikojmë ndreqjen e gabimeve. Ky është momenti kur Krishti na ktheu me Perëndinë për të jetuar përjetësisht. Festimi i Krishtlindjes është krejt ndryshe nga Viti i Ri. Krishtlindja është fillimi i luftës sonë për t’u ribashkuar me Perëndinë. Me

ardhjen e Krishtit, erdhi drita e transformimit të botës”-nënvizoi gjatë fjalës së tij Hoppe.

Të dielën, pjesëmarrësit e Konferencës zbritën në qytetin e Durrësit, për të marrë pjesë në celebrimin e Meshës Hyjnore në Kishën e Shën Pavlit dhe Shën Astit. Kjo ditë përkonte edhe me festimin e ditës së Shën Spiridhonit. Liturgjia Hyjnore u drejtua nga Drejtori i Akademisë Teologjike, Hirësi Ilia, i cili mbajti edhe predikimin e rastit, duke falënderuar të gjithë studentët që morën pjesë në “banкетин e Krishtit” - siç e cilësoi ai.

Isidor Koti

Rinia e Kavajës, fituese e Festivalit të Dioqezës së Tiranës

Të rinjtë orthodhoksë të Kavajës fituan çmimin e parë në Festivalin e Dioqezës së Tiranës, i cili u organizua me rastin e Krishtlindjeve, më 26 dhjetor 2004 në sallën kulturore të Manastirit të Shën Vlashit. Si çdo fundvit, edhe këtë herë të rinjtë e ardhur nga disa qytete të vendit shpалosën vlerat më të mira tradicionale të këngëve dhe valleve të trevave të tyre. Ata u paraqitën fillimisht me një këngë të krishterë dhe më pas me këngë popullore ose valle, duke krijuar një atmosferë të vërtetë festive. I ftuar i veçantë i këtij aktiviteti ishte edhe Drejtori i Akademisë Teolo-

gjike, Hirësi Ilia Ketri, i cili përshëndeti të rinjtë e ardhur nga Durrësi, Elbasani, Gjinari, Kavaja, Tirana e Shkodra për pjesëmarrjen e tyre në këtë festival. Grupi fitues i

Kavajës do të marrë pjesë në Festivalin Kombëtar të Rinisë Orthodhokse, i cili pritet të organizohet gjatë muajve në vazhdim.

I. Koti



Në mjediset e Manastirit të Shën Vlashit u organizua një kamping dimëror, në periudhën e pushimeve të fundvitit. Në të morën pjesë 60 vajza, nxënëse në shkollën e mesme dhe studente, të cilat morën pjesë së bashku në veprimtari shpirtërore dhe argëtuese.

Dashuria e Perëndisë mishërohet

(vijon nga faqja 1)

Perëndia i dashurisë nuk e braktisi botën, e cila gjen vdekjen nga egoizmi dhe urrejtja. Ai lëviz midis nesh, brenda qyteteve tona të zhurmshme, në shkretëtirën e vetmisë sonë, duke dhënë fuqi dashurie, duke falur kuptim dhe plotësim në jetë.

Tij është të zbulojë dhe të bëjë të pranishme dashurinë hyjnore tek e këtushmja dhe e tanishmja”, në çdo çast kohor dhe në çdo vend, ku gjendet dhe vepron. Çdo shprehje e jetës së saj, adhurim, fjalë, strukturë administrative, aktivitet, vepër sociale, vetëm kur mishërojnë këtë dashuri të përjetshme të Perëndisë, përderisa e bëjnë vepruese dhe të dukshme, kanë rëndësi dhe vlerë të vërtetë. Unikaliteti i Kishës së Krishtit qëndron pikërisht në faktin se, në shprehjet e ndryshme të qenies njerëzore, të shoqërisë njerëzore, në vlerat e ndryshme të kulturës, ofron dashurinë, në formën e saj autentike. Nëse ajo pushon së shërbyeri “këtij misteri të madh të shpresëtarisë” (1 Tim. 3:16), që përmbledh fakti se Perëndia i dashurisë “u shfaq në mish”, atëherë “bëhet enë bakri që kumbon ose cimbal që tingëllon”, qoftë edhe nëse ka profeci, dije, edhe nëse njih tërë misteret, qoftë dhe nëse kryen vepra të rëndësishme dhe impresionuese (1 Kor. 13:1-3).

Unikaliteti i Kishës së Krishtit qëndron pikërisht në faktin se, në shprehjet e ndryshme të qenies njerëzore, të shoqërisë njerëzore, në vlerat e ndryshme të kulturës, ofron dashurinë, në formën e saj autentike.

Dashuria e krishterë nuk mbetet në gjëra të përgjithshme dhe të papërcaktuara. Ajo ka shprehje konkrete në jetë - zbulohet në marrëdhëniet njerëzore: “Dashuria është zemërgjerë, bën të mira, dashuria nuk ka smirë, dashuria nuk krekoset, nuk mbahet me të madh, nuk sillet shëmtuar, nuk kërkon të vetat, nuk zemërohet, nuk mendon të keqen, nuk gëzohet me padrejtësinë, por gëzohet me të vërtetën; të gjitha i mban, të gjitha i beson, të gjitha i shpreson, të gjitha i duron. Dashuria kurrë s’bie poshtë” (1 Kor. 13:4-8).

* * *

Këto të vërteta nuk janë të pranueshme nga të gjithë njerëzit. Gjatë shekujve, të shumtë ishin ata që nuk e pranuan dhe nuk iu përgjigjën dashurisë së Perëndisë. Disa u tallën me të, të tjerë dyshuan, të tjerë e urreyen, disa të tjerë e injoruan. Megjithatë, miliona shpirta nga të gjitha shtresat shoqërore, nga të gjithë popujt dhe kategori njerëzish, të shkolluar e të pashkolluar, të pasur e të varfër, të privilegjuar ose jo, besuan se “aq shumë e deshi Perëndia botën sa që dha të Birin e Tij të vetëmlindur, që të mos humbasë kushdo që do t’i besojë atij, por të ketë jetë të përjetshme” (Jn. 3:16). Dhe u përpoqën, brenda mundësive, të mbeten në dashuri, ta bëjnë atë vizion, ideal, akt, vepër dhe përpjekje. Njerëzimi u detyrohet të gjithë atyre me mirënjohje të madhe. Duke pasur dëshirë të zjarrtë t’i afrohen Perëndisë dhe të bashkohen me Të, ata “mbetën” në dashuri. Dhe siç na zbulon Ungjillor Joani, “Perëndia është dashuri, dhe kush mbetet në dashuri, mbetet tek Perëndia dhe Perëndia tek ai” (1 Jn. 4:16).

Çdo qelizë e Trupit të dukshëm të Krishtit, të Kishës, çdo besimtar, është thirrur me anën e pagëzimit dhe pjesëmarrjes në Eukaristinë Hyjnore, që dashuri-

Konfirmimi se “Perëndia është dashuri”, na ngushëllon dhe na çliron nga frika e shumëllojshme, nga frika e tjetrit, që është ndryshe, e të panjohurit, e zhvillimeve të njerëzimit që shpesh parashihen si kërcënuese. Nga frika prej dështimeve dhe ndonjëherë prej humnerës së shpirtit tonë. “Frikë nuk ka në dashuri. Por dashuria e përkryer e nxjerr jashtë frikën” (1 Jn. 4:18).

* * *

në e Perëndisë ta shprehë, ta bëjë të dukshme, ta shfaqë, “ta mishërojë” me qenien dhe veprën e tij, në të gjitha kushtet ku jeton. Kush mbetet tek Perëndia, nuk mund të mos dojë ashtu si Ai, me një dashuri që ndërmerr nisma të guximshme, që nuk njih kufij, paragjykime, që përfaqon gjithçka.

Konfirmimi se “Perëndia është dashuri”, na ngushëllon dhe na çliron nga frika e shumëllojshme, nga frika e tjetrit, që është ndryshe, e të panjohurit, e zhvillimeve të njerëzimit që shpesh parashihen si kërcënuese. Nga frika prej dështimeve dhe ndonjëherë prej humnerës së shpirtit tonë. “Frikë nuk ka në dashuri. Por dashuria

Këto ditë të shenjta, vëllezër dhe motra, le t’i lëmë mënjanë elementet e shumta të jashtme, zakonet që shpesh nuk kanë të bëjnë fare me thelbin e Ngjarjes, dhe le të mendojmë më me kujdes bërthamën e festës së Krishtlindjeve, pra, se me ardhjen e Tij në botë, Krishti zbuloi, “Mishëroi” dashurinë e përjetshme të Perëndisë. Dhe le t’i shtojmë përpjekjet për të rregulluar qëndrimin dhe sjelljen tonë të përditshme sipas kësaj të vërtete. Le ta mishërojmë dashurinë tonë me pastrim të ndjenjave tona për të tjerët, me iniciativa dhe vepra konkrete dashurie. Dhe le t’i për-

Fakti që dashuria përbën vlerën më të lartë të jetës, fuqinë mistike të botës, aq më shumë bëhet e pranueshme... bëhet një rrugë e fshehtë kalimi që i çon njerëzit - ndoshta pa e kuptuar - pranë Perëndisë së Dashurisë. Kjo, besojmë, përbën qëllimin final të ecjes së botës.

e përkryer e nxjerr jashtë frikën” (1 Jn. 4:18).

Madje, dhe shumë njerëz që mohojnë ose që nuk duan të pranojnë fjalën “Perëndi”, në mënyrë indirekte ata pranojnë emrin tjetër të Tij: “Dashurinë”. Fakti që dashuria përbën vlerën më të lartë të jetës, fuqinë mistike të botës, aq më shumë bëhet e pranueshme, nëpërmjet përvojave të ndryshme dhe mënyrave të të menduarit. Ky fakt bëhet një rrugë e fshehtë kalimi që i çon njerëzit - ndoshta pa e kuptuar - pranë Perëndisë së Dashurisë. Kjo, besojmë, përbën qëllimin final të ecjes së botës.

gjërohemi të Trupëzuarit: O Zot, Ti që erdhe midis nesh për të shfaqur dashurinë e pakufishme të Perëndisë, e cila përfaqon dhe transformon gjithçka, qëndro tek ne, sidomos gjatë këtyre ditëve. Dhe gjatë Vitit të Ri që do të vijë pas pak ditësh, na bëj të denjë që të mbetemi të qëndrueshëm në dashuri tek Ty. Për shumë vjet të bekuara dhe të gëzuara!

Me uratat e zjarrta të Perëndisë,

Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë
+ Anastasi

Besimtarët Orthodhoksë kremtojnë Krishtlindjet dhe Ujin e Bekuar

Dita e Theofanisë në Berat ishte madhështore



Beratin, në kremtimin e Ujit të Bekuar, duket sikur Perëndia e ka përkëdhelur për madhësinë, bukurinë që ka kjo e kremte e veçantë në këtë dioqezë. Si çdo vit u bë Bekimi i Ujit në orën 5:30 në lumin Osum, në prani të shumë besimtarëve, nga At Petraqi. Në orën 6:00 filloi Liturgjia Hyjnore në kishën e Shën Spiridhonit, që u krye nga Imzot Ignati.

Kishën e kishin mbushur si brenda dhe jashtë shumë besimtarë të të dy komuniteteve, traditë kjo e bukur në këtë qytet si gjithmonë jo vetëm nga Berati, por dhe nga trevat e dioqezës dhe nga veriu e jugu dhe nga diaspora, si nga Greqia, Italia, Franca etj.

Pas Liturgjisë Hyjnore besimtarët, me respekt si gjithmonë, dëgjuan mesazhin që përcjell kjo ditë e bekuar dhe thirrjen morale e shpirtërore që bëri Imzot Ignati për të dëmtuarit e tërmetit në Azinë Juglindore, për të qenë sa më pranë me sa kemi mundësinë.

Në orën 10:00, Imzot Ignati i shoqëruar nga At Petraqi dhe dhjakon Spiridhoni u nisën për tek Ura e Goricës, vendi simbol i hedhjes së Kryqit.

Me qindra besimtarë, duke kënduar himnin e Pagëzimit, shoqëronin Imzot Ignatin dhe klerikët. Ura dhe brigjet përreth janë mbushur plot përplot. Bijtë e Dritës, djemtë besimtarë në këtë mot të ftohtë tipik të lagjes Goricë, presin në ujë e s'duan t'ia dinë, se kanë pranë Perëndinë.

Kryqin e hodhi Imzot Ignati. Ai u kap nga djemtë e Goricës, Fredi

Petraq Xhimitiku, Vasil Ilia Shyti, dhe Kristaq Thoma Sinjari.

Dy të parët kanë ardhur enkas nga Greqia për të marrë pjesë në këtë ceremoni, ndërsa Kristaqi është student në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë. Kryqin, grupi ia dorëzoi Kryebariut, Imzot Ignatit, ku morën dhe bekimin "Bijtë e Dritës". Me kryqin në dorë filluan ritin e tyre tradicional, duke bërë vizita nëpër familje. *S.M.*

Në qytetin e Korçës u kremtuan me madhësi festat e Krishtlindjes dhe Ujit të Bekuar

Edhe këtë vit në qytetin e Korçës u kremtuan me madhësi festat e Krishtlindjes dhe të Ujit të Bekuar. Vetë gëzimi që transmetojnë këto festa ndihej shumë ditë përpara, në qytetin e traditave të mëdha Orthodhokse.

Festimet për festën e Krishtlindjeve filluan dy javë para datës 25 dhjetor. Aktiviteti që hapi këtë

periudhë festive ishte një shfaqje me muzikë bizantine nga Kori Bizantin i Edesës. Ishte ky aktivitet që trokiti i pari, duke thyer kufijtë e gjuhëve të ndryshme dhe duke transmetuar tek të gjithë gëzimin e festës që po afronte.

Aktiviteti që pasoi ishte festivali i dioqezës, që tashmë është bërë një traditë e përvitshme. Edhe



Kremtime të gëzueshme në Elbasan

Afrimi i Krishtlindjeve u prit me shumë shpresë nga besimtarët orthodhoksë të qytetit të Elbasanit e fshatrave të tij. Kisha e Shën Nikollës qysh në orët e para u mbush plot e përplot. Celebrimi i

Liturgjisë Hyjnore u krye nga Hirisia e Tij Ilia dhe klerikë të tjerë, i cili mbajti edhe predikimin e rastit. Më pas pritja e organizuar po në këtë kishë solli drejtuesit e *(Vijon në faqen 8)*



në këtë aktivitet festiv ku morën pjesë të rinj nga e gjithë dioqeza, u përçua me nota festive tek çdo njeri "Lajmi gazmor dhe i çuditshëm, që vinte nga Betlehemi". Ishte ky lajm që mblodhi shumë besimtarë, dhe personalitete të qytetit në këtë aktivitet festiv, ku grupit të fshatit Polenë iu dha edhe çmimi i parë. Dhe rruga për të takuar Foshnjën e Betlehemit vazhdon, në aktivitetin pasardhës.

Kolendrat janë një festë tradicionale për qytetin tonë. Grupe fëmijësh, të rinjsh, të moshuarish, lëviznin gëzueshëm në rrugët e qytetit dhe lajmëronin kudo për Atë, që do të lindte. Për një natë të vetme të gjithë patën privilegjin të ishin engjëj që lajmëronin Lindjen e Shpëtimtarit. Në çdo sokak të qytetit takoje grupet që gëzueshëm këndonin: "Kolendra, Kolendra sot gëzuar për shumë mot, Zotërinj dhe Zonja".

Por kulmi i festave ishte data 25. Njerëz të çdo moshe u mblodhën së bashku në kishat e qytetit,

(Vijon në faqen 8)

Lindja e Krishtit - simbol i dashurisë dhe i shpresës

Muaji dhjetor, tek besimtarët e Beratit ka mjaft kremtime, por edhe diçka të veçantë. Katedralja e Shën Spiridhonit kremton këto ditë të shënuara. Këtu, më 13 dhjetor të vitit 1990 rihapi për herë të parë dyert streha e Perëndisë.

Po në këtë kishë, më 20 dhjetor u kremtua me madhështi dita e Shën Ignatit. Për të nderuar Kryebariun e dioqezës që mban emrin e shenjtit kishin ardhur në këtë Liturgji shumë besimtarë. Pas saj shumë besimtarë shkuan në Mitropoli, ku i uruan emrin Imzot Ignatit. Një grup fëmijësh dhanë një montazh artistik.

E kremtja më e madhe, ajo e Lindjes së Krishtit, u kremtua me madhështi. Në orën 5 të mëngjesit filluan shërbesat, që u kryen nga Imzot Ignati, i shoqëruar nga At Petraqi dhe dhjakon Spiridhoni. Pas Liturgjisë, Imzot Ignati në predikimin e tij theksoi: "Perëndia është dashuri dhe zëri i urtësisë, bashkimit dhe këtë e risjell i vetlinduri, i biri i Perëndisë. Kjo është ajo që dallon, e përcakton besimin kristian. Ky virtyt është jetësor, ai ndodh në marrëdhënie të vazhdueshme, është në lëvizje. Kjo dashuri mbetet përjetësisht në trupin mistik të Krishtit, që është Kisha. Dashuria është zemërgjerë, ajo nuk gëzohet me padrejtësinë, por me të vërtetën, sepse ajo përbën vlerën

më të lartë të jetës. Ajo është sinonim i dashurisë, ndaj i çon njerëzit pa e kuptuar pranë dashurisë - vëllazërisë".

Pas faljes shumë besimtarë, përfaqësues të pushtetit lokal e forcave politike, të komunitetit mysliman etj., bënë vizita në Mitropoli, për t'i uruar Krishtlindjet Imzot Ignatit dhe gjithë besimtarëve orthodhoksë. Me këtë rast Hirësia e Tij i dha televizionit lokal një mesazh urimi.

Edhe në qytetet e fshatrat që përfshihen në Mitropolinë e Beratit u kremtua me madhështi, dita e Ujit të Bekuar.

Falë organizimit nga Mitropolia u bë e mundur që të zhvillohen Liturgji në të gjitha enoritë.

Në Vlorë, nën drejtimin e At Kostandin Priftit, kryqi u hodh në ujërat e bregut të detit, në orën 10⁰⁰, në prani të shumë besimtarëve.

Në Fier, At Ilia Bita në shatërvanin e qytetit hodhi kryqin, që simbolizoi bekimin e ujit.

Në Lushnjë, At Ilia Prifti në kishën e Shën Gjergjit bëri bekimin e ujit në prani të shumë besimtarëve.

Në Kuçovë, At Bartolome Bullari në kishën "Ngjallja e Krishtit" bëri bekimin e ujit, ndërsa shumë besimtarë shoqëronin shërbesën duke kënduar himin "Në Jordan kur pagëzohesh, o Zot" etj.

Sotiraq Mishaxhiu, Berat

Në qytetin e Korçës u kremtuan me madhështi festat e Krishtlindjes dhe Ujit të Bekuar

(Vijon nga faqja 7)

ku u celebrua edhe Liturgjia Hyjnore, duke ndarë me njëri-tjetrin gëzimin e festës. Në Katedralen e qytetit "Ngjallja e Krishtit" Liturgjia u kryesua nga Mitropoli i Korçës, Imzot Joani, i cili në predikimin e Tij foli për gëzimin që kjo festë transmeton dhe për nevojën që ka shoqëria e sotme për këtë gëzim Hyjnor, që na jepet dhuratë nga foshnja e Betlehemit.

Më pas u vazhdua me pritjen e urimeve në selinë e Mitropolisë, ku erdhën dhe uruan autoritetet më të larta të shtetit, si Kryeministri i Shqipërisë, z. Fatos Nano, përfaqësues të komuniteteve fetare dhe besimtarë të ndryshëm. Gjithashtu uroi në datën 26 dhe ish-Presidenti dhe Kryetari i Partisë Demokratike, z. Sali Berisha.

Me rastin e kësaj feste, me bekimin dhe përkujdesjen e Mitropolitit Joan, po në këtë ditë u organizua një drekë për të gjithë njerëzit në nevojë, si dhe u ndanë pako me

dhurata për fëmijët e policëve që janë vrarë në krye të detyrës dhe për fëmijët e Komunës Barmash, fshatrat e së cilës janë dëmtuar nga tërmeti.

Ishte ky gëzim dhe këto aktivitete, të cilat vazhduan deri në ditën e Ujit të Bekuar, ditë që në Mitropolinë e Korçës celebrohet në mënyrë shumë madhështore. Edhe në këtë të kremte Liturgjia u drejtua nga Mitropoli i Korçës, Imzot Joani, i cili përsëri theksoi: "Duhet të gjithë të përpiqemi, që dritën që lindi në shpellën e Betlehemit ta mbajmë ndezur, duke mos u trembur nga Herodët, që përpiqen ta shuajnë".

Më pas shërbesa vazhdoi me hedhjen e Kryqit në ujërat e liqenit të Pogradecit, ku morën pjesë qindra besimtarë. Ishte kjo atmosfera që pushtoi dioqezën e Korçës, çdo zemër të krishterë dhe, është kjo atmosferë që duhet të na karakterizojë gjatë gjithë jetës sonë si të krishterë.

Vangjel Qazimllari

Kremtime të gëzueshme në Elbasan

(Vijon nga faqja 7)

pushtetit lokal, krerët e komuniteteve fetare, deputetë dhe përfaqësues partish etj.

Kremtimi i ditës së pagëzimit të Zotit tonë Jisu Krisht në lumin Jordan dhe shenjtërimi i ujërave mbledhi përsëri të gjithë ortho-

dhoksët e këtij qyteti. Besimtarët e shumtë vinin nga lagjja "Kala", nga "Shën Thanasi", nga "Shën Joan Vladimiri", nga Kuçani e gjer nga Shelcani.

Së bashku me Episkop Ilian bashkëmëshuan At Gjergji, At Pali, At Stavri, At Joani, At Petraqi dhe dhjakon Emanueli. Pas Liturgjisë Hyjnore u krye edhe shërbesa e shenjtërimin të ujërave. Interesi i besimtarëve për ta ndjekur veprimtarinë ishte i jashtëzakonshëm. Gëzimi i kremtimit mbushi të gjitha rrugët. Shërbesa e bekimit të ujit u krye në pishinën e hotel "Kriva".

Episkop Ilia e hodhi atë dhe menjëherë shtatë djem u futën në ujë. Kryqin e ngriti lart i riu orthodhoks Elton Halili nga Sopotit i Librazhdit.

Episkop Ilia dhe klerikët e tjerë i uruan Eltonit drejtësinë në besimin e tij orthodhoks, mbarësi, shëndet e suksese në mësim. Kështu u mbyll edhe kjo e kremte e bekuar.

At Stavri Çipi, Elbasan

Aktivitet kulturor për të rinjtë me aftësi të kufizuara

Në prag të Krishtlindjeve, Zyra Kombëtare e Rinisë e Kishës Orthodhokse Shqiptare zhvilloi në Durrës një takim kulturor dhe argëtues për të rinjtë me aftësi të kufizuara.

Në të morën pjesë rreth 25 persona me probleme fizike. Ata kaluan së bashku ditë të gëzuara, duke zhvilluar një jetë të pasur dhe aktive, me diskutime, lojëra, humor etj.

Veprimtaria quhej "Fundjava e miqësisë" dhe u realizua me bekimin e Kryepiskopit Anastas. Qëllimi ishte që përmes këtij aktiviteti të vendosej një urë lidhëse pa dallime e paragjykimet.

Çdo gjë kaloi lirshëm me këngë, valle, demonstrime të talenteve të këtyre njerëzve, të cilët kanë një botë të pasur shpirtërore, guxim dhe

këmbëngulje për të jetuar. Ky ishte viti i tretë radhazi që të rinjtë orthodhoksë organizojnë një takim të tillë.



Programi Rajonal për Trashëgiminë Kulturore në Evropën Juglindore

Bërthama e Trashëgimisë Kulturore e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë përfaqësohet me gjashtë materiale të objekteve tona të kultit në Programin Rajonal për Trashëgiminë Kulturore në Evropën Juglindore, duke kaluar kështu me sukses të dy fazat e para të programit dhe duke zënë një pjesë të rëndësishme të 22 materialeve të kualifikuara për të gjithë Shqipërinë, të përgatitura nga institucione të ndryshme.

Puna ka filluar gati një vit përpara, duke përgatitur materialet e nevojshme për të plotësuar kërkesat specifike dhe të detajuara të programit. Për këtë u përdorën materialet dhe studimet e Bërthamës së Trashëgimisë Kulturore si dhe u shfrytëzua përvoja e saj e përfutur gjatë restaurimit të disa dhjetëra objekteve të kultit. Por ç'përmban ky program, cilat janë qëllimet e tij?

Programi Rajonal për Trashëgiminë Kulturore dhe Natyrore në Evropën Juglindore, është Program i Këshillit të Evropës për vendet e Evropës Juglindore si kontribut për bashkëpunim në shkallë të gjerë të këtyre vendeve në drejtim të mbrojtjes, konservimit, rehabilitimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, duke vënë theksin në zhvillimin e qëndrueshëm në drejtim të administrimit urban dhe rural, zhvillimit lokal të kushteve të jetesës dhe mjedisit. Qëllimet politike të programit janë aktuale dhe të qenësishme, ato synojnë ndërtimin e një identiteti evropian të bazuar në njohjen e diversitetit rajonal, tolerancën dhe dialogun mes bashkësive duke e konsideruar trashëgiminë forcë që gjeneron paqe dhe bashkim.

Programi përbëhet nga tri komponentë kryesorë: Plani për Ndërtimin e Kapaciteteve Institucionale, i cili synon forcimin e institucioneve në drejtim të menaxhimit të projekteve komplekse dhe hartimin e strategjive dhe politi-

kave ku të afirmohet trashëgimia si faktor për zhvillim ekonomik, social dhe shpirtëror, Plani për Projektin e Rehabilitimit të Integruar, dhe Projekti Pilot për Zhvillim Lokal, i cili synon mbështetjen e demokracive lokale dhe zhvillimin e partneritetit ndërrajonal.

Bërthama e Trashëgimisë Kulturore e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë në programin e mësipërm, merr pjesë në komponentin B të tij, i cili synon në financimin e disa objekteve të rrezikuara me qëllim përmirësimin e gjendjes aktuale të monumenteve

të trashëgimisë kulturore në gjithë rajonin nëpërmjet projekteve të restaurimit. Ky projekt është iniciativë e përbashkët e Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian nëpërmjet ish-Presidentit të tij, z. Romano Prodi.

Bërthama e Trashëgimisë Kulturore ka pëmbushur deri tani dy fazat e para të projektit, që janë hartimi i një raporti mbi gjendjen e objekteve të kultit të paraqitura. Në listë janë përfshirë objekte të tilla si: Kisha e manastirit të Shën Marisë në Goranxi, Dropull; Manastiri i Fjetjes së Hyjllindëses në Kakome, Sarandë; Kisha e manastirit të Shën Prodhromit në Voskopojë; Kisha e Kozares në Berat; Kisha e Shën Kollit në Krutjen e sipërme, Lushnjë dhe manastiri i Shën Gjergjit në Sarandë. Plotësimi i dy fazave të para të projektit ka qenë dëshmi jo vetëm e angazhimit serioz të Bërthamës së Trashëgimisë Kulturore në këtë projekt, por dhe e interesimit të madh që ka treguar dhe tregon Kryepiskopi Anastas për rimëkëmbjen e trashëgimisë kulturore të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Adresat e faqeve në Internet dhe ajo e E-mail-it,

të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, janë:

Internet: www.orthodoxalbania.org

E-mail: orthchal@orthodoxalbania.org

Përgatiti:
Gentian (Joan) Stratobërdha

Nga Shenjtorët e muajit

Grigori Nisës (10 janar)

Atë i madh, pionier i misticizmit, si edhe theolog e filozof, kërkues shumë i thellë, ishte bir i Vasilit dhe Emelisë dhe vëlla i Vasilit të Madh (1 janar) dhe oshënare Markrinës (19 korrik). Lindi më 335, në Neocesari të Pondit. Studioi Shkrimin e Shenjtë, oratori etj.

Martohet me Theosevinë (greqisht = perëndibesimtare), me të vërtetë shpresëtare, të cilën më pas e dorëzoi në dhjakonëshë, dhe kremtohet sot bashkë me të, por i trishtuar rrëfen dhe lavdëron lartësinë e virgjërisë!

Jeton në mënyrë asketike i udhëhequr nga Vasili i Madh. Vasili, vëllanë e tij të mbyllur në vetvete e detyron dhe e bën episkop në një qytezë të arqipiskopatës së tij, në Nisë.

Meqë Grigori lufton arianitetin, ata shpifin për të si abuzues me paratë e Kishës dhe më 375 arrestohet, por arratiset. Një vit më vonë e çkishërojnë.

Por, mbas vdekjes (378) së perandorit arianit Valentit (364 - 378), kthehet në mënyrë triumfale tek populli i tij. Gjithashtu, kthehet

shpejt edhe nga qyteti i Sevastisë, ku orthodhoksët e kishin transferuar më 380, me gjithë kundërshtimet e tij.

Merrte pjesë në sinode dhe sidomos në Sinodin II Ekumenik në Konstandinopojë (381), ku doktrina e tij përbën artikullin për Shpirtin e Shenjtë në Simbolin e Besimit. Fjeti me sa duket më 394.

Zotërues i teologjisë dhe i arsimit “të jashtëm” ose “jashtë deryve” [të teologjisë] dhe sidomos i Platonit, sistemoi dogmat, duke u përpjekur t’i shpjegojë disi me logjikë, për hir të popullit të thjeshtë që atëherë e teologjizonte gjerësisht. Në morinë e shkrimeve të shkëlqyera të tij përfshihen vepra shpjeguese (si “Rreth jetës së Moisiut” dhe shpjegime të “Këngës së Këngëve”), dogmatike (si “Fjalimi i madh i katekizimit” e kundërshtuese kundër herezive të ndryshme), praktike - shpirtndërtuese (si “Rreth virgjërisë” dhe Jeta e Markrinës), fjalime dhe letra.

Me Vasilin e Madh e Grigor Theologun (25 janar) përbën treshen e Etërve të mëdhenj të Kapadokisë.

Kirilli i Aleksandrisë (18 janar)

Mësues ekumenik. Lindi më 375 prej aleksandrianësh të njohur dhe ka mundësi që asketoi pranë të afërmit të tij oshënar, Isidhor pilusioti (4 shkurt), të cilin e respektonte gjithmonë.

Më 412 zëvendësoi në patriarkanën e vendlindjes xhaxhanë e tij, Theofilin, armik i shën Joan Gojartit (13 nëntor). Por Kirilli e rivendosi emrin e atit të madh në diptikët (në listën) e Kishës së Aleksandrisë (416).

I arsimuar dhe veprimtar, shpesh mjaft këmbëngulës, organizoi përkujdesjen që ushtronin infermierët, pajisi Kishën me anije, që tregotnin grurin e Egjiptit dhe sidomos luftoi kundër herezive dhe idhujtarisë.

Shumë popullor, ia kaloi në prestigj qeveritarit politik dhe kur hebrenjtë vepruan dhunshëm ndaj të krishterëve, shenjt i dëboi nga qyteti! Më pas disa fanatikë vranë idhujtaren e famshme, filozofen, të virgjërën Ipatia, sepse besonin se nxiste qeveritarin kundër patrikut. Kirilli u akuzua, por padrejtësisht.

Më vonë luftoi kryeheretikun Nestor. E diskretitoi duke i shkruar herë pas here drejtpërdrejt familjes perandorake, ndërsa atij vetë i dërgoi “Dymbëdhjetë anatema”-t e tij tërësisht teologjike.

Kryesoi fuqishëm Sinodin III Ekumenik (431) në Efes, që çkishëroi Nestorin. Por perandori, shën Theodhosi II (29 korrik), burgosi Kirillin bashkë me kryetarin e herezisë, që të detyroheshin të bënin kompromis(!), por më pas mbreti u bashkua me shenjtin, mbase i ndikuar nga e motra, shën Pulkeria (17 shkurt) dhe e liroi. Ai u kthye dhe qëndroi si patrik deri në fjetjen e tij (27.6.444).

Prej veprave të tij të shumta shpëtuan gjysmat, të cilat janë shpjeguese, apologjetike (pohuese), antiheretike (midis tyre dhe më metodikja që u shkrua ndonjëherë kundër arjanistëve), liturgjike, fjalime dhe letra, si të tri letrat “Ekumenike”. Frymëzoi shumë theologë. Kremtohet edhe i vetëm, më 9 qershor.



episkopi i tij, Jakovi (13 janar). Njihte edhe filozofi greke, veçse nuk dinte gjuhën.

Shumë herët u bë murg dhe më vonë dhjak, por nuk pranoi të lartësohet në episkop. Në Nisivi spikat si shtylla e shkollës teologjike të tij, orator i vrullshëm dhe përluftar i Orthodhoksisë kundër heretikëve, deri sa më 363 qyteti pushtohet nga persët. Dhjakoni oshënar mbasi u

Ati më i madh sirian, theolog dhe poet. Flitet se shkroi 3.000.000 vargje! Lindi rreth vitit 306 në Nisivi të Mesopotamit, u edukua me krishterimin dhe u arsimua nga

mundua afër grigjës së tij, erdhi në Edhesë të Mesopotamit.

Aty, në vend të takohet me një burrë shpirtprurës, siç ishte lutur, ndeshi një prostitutë, që e vështro-

Efrem siriani (28 janar)

nte pa ia ndarë sytë. Vërejtjes së tij, iu përgjigj se e vështronte, meqë si grua u krijua prej brinjës së tij, ndërsa ai duhej të shikonte jo atë, por dheun nga i cili u formua. Dhe Efremi (sirisht = pjellori e dyfishtë) nga kjo përfitoi.

Në Edhesë jetoi si eremit në një mal afër, vazhdoi të ushtruarin e tij të rreptë dhe virtytin e tij dhe qante vazhdimisht duke studiuar Gjyqin e fundit dhe Parajsën.

Herë pas here vepronte mes besimtarëve, që e respektonin shumë. Kështu, në zinë e bukës më 372, bindi të pasurit të vendosin nën administrimin e tij pasuritë e tyre, sa që iu shërbente të sëmurëve në

treqind krevate dhe kujdesej për të gjithë nevojtarët.

Rigjallëron shkollën teologjike të Edhesës; shkruan himne tronditëse “kataniktike” (shpirtdërrmuese), që futen në adhurim që kur ishte gjallë; komponon dhe shpjegon vetë muzikën frymëmadhe të tyre; shpjegon gjithë Shkrimin; restauron format e ndryshme të murgjërisë dhe me “Tipikotë” që formulon, i vë një themel të qëndrueshëm. Mëson, mahnit, shpëton. Thuhet se vizitoi Vasilin e Madh (1 janar), në Qesari.

Fjeti më 9.6.373, dhe kishte urdhëruar që më përpara, i përluri, të vendosej në varrezën për të huajt. E madhështuan Etër të mëdhenj.

At *Justini*

KBK dhe KEK deklarojnë mbështetjen e tyre për Patriarkanën Ekumenike

Më 10 dhjetor, Këshilli Botëror i Kishave dhe Konferenca Evropiane e Kishave, nëpërmjet sekretarëve të tyre të përgjithshëm, Rev. Dr. Samuel Kobia dhe Rev. Dr. Keith Clements, shprehën "keqardhjen e tyre të thellë mbi njoftimet për presionet e vështirësitë e reja ndaj Patriarkanës Ekumenike".

Në një letër drejtuar Patriarkut Ekumenik, Tërëshenjtërisë së Tij Vartholomeu I, thuhej: "Na prekin kur lexojmë kritikën publike dhe sulmet kundër jush dhe kundër komunitetit të krishterë në Turqi. Kjo armiqësi mund të jetë e vështirë për t'u përballuar, kur i shton edhe ndjenjën e izolimit që ajo sjell... Ne dëshirojmë Tërëshenjtëria Juaj, ashtu si edhe gjithë vëllezërit dhe motrat që janë nën drejtimin tuaj në gjithë botën, të mësoni solidaritetin tonë me ju dhe lutjet tona në këtë kohë të vështirë."

Letra vazhdon: "Besojmë se përkrahja juaj e duruar dhe e vendosur për pranimin e Turqisë në Bashkimin Evropian do të vlerësohet dhe riafirmohet nga të gjithë. Për ata që ju njohin prej shumë kohësh, ky është një shembull me shumë integritet që ju keni treguar si lider në gjithë botën Orthodhokse dhe në lëvizjen ekumenike, ku ju jeni deklaruar gjithmonë për dialogun, pajtimin dhe paqen në gjithë botën, ashtu si edhe për unitetin e krishterë."

Konstandinopojë

Patriarku Ekumenik Vartholomeu I, në Mesazhin e Tij të Krishtlindjeve foli për një botë të goditur nga kriza dhe vuajtje, të cilat ai i vuri përballë shpresës së krishterë. "Ne, - tha Tërëshenjtëria e Tij, - besojmë dhe e dimë mirë se shpëtimi nuk duhet gjetur askund tjetër, por tek Krishti, dhe nuk ka asnjë emër tjetër që mund të na shpëtojë veç atij të Jisu Krishtit... Ne ftojmë gjithë qeniet njerëzore, pavarësisht nëse e njohin apo jo Krishtin, të vijnë afër Tij."

Rusi

Të krishterët Orthodhoksë të Rosisë i kremtuan Krishtlindjet në datën 7 janar (sipas kalendarit julian), me shërbesa dhe veprimtari kulturore. Patriarku Aleksej, drejtoi Liturgjinë Hyjnore në Katedralen e Krishtit Shpëtimtar, në Moskë dhe e quajti rilindjen e Kishës një mrekulli. Mijëra vetë ishin të pranishëm në kishën e ringritur, që u shkatërrua më 1931 me urdhër të Stalinit. Më pas, në kishën e njohur të Shën Vasilit, jashtë Kremnit, aktorë dhe këngëtarë dhanë një shfaqje duke pasur si sfond një paraqitje të Lindjes. Gjithashtu, në

një park të qytetit u zhvillua një koncert me pjesëmarrjen e mijëra të rinjve etj.

Bullgari

Patriarku Maksim i Bullgarisë drejtoi në mëngjesin e së shtunës kremtimin e Liturgjisë Hyjnore në katedralen "Shën Aleksandër Nevski", në Sofie, së bashku me Mitropolitin e diasporës, Josifin (SHBA, Kanada, Australi) dhe pjesëtarë të Sinodit të Shenjtë. Krishtlindjet (Kolenda në bullgarisht) festohen me madhësi në këtë vend, që ka rreth 83 për qind të popullsisë të besimit Orthodhoks. Krishtlindjet fillojnë një ditë më parë, para mesnatës, me traditën e "koleduvane" (kolendrave), kur djem dhe burra të pamartuar, kolendarët, vizitojnë shtëpitë e besimtarëve duke kënduar këngë që urojnë bollëk dhe shëndet për të zotët. Në qytete kjo traditë nuk ndihet kaq shumë, por nuk janë të rralla rastet që grupe fëmijësh trokasin në dyert e banorëve për të kënduar këngët e rastit dhe uruar.

Serbi

Patriarku Pavle drejtoi Liturgjinë e Krishtlindjeve, në datën 7 ja-

Nga bota Orthodhokse

Nga festimi i Krishtlindjeve në botë

nar, në Katedralen e Beogradit. Në mesazhin e së kremtes, iu drejtua veçanërisht të rinjve, duke u rekomanduar që të tregojnë "seriozitet dhe përgjegjësi ndaj Perëndisë, ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj gjithë botës ku jetojmë."

Betlehem

Sipas kryetarit të bashkisë së qytetit të Lindjes, të krishterët patën këtë vit një të kreme të trishtuar, për shkak të bllokadës që iu bë qytetit nga ushtarët izraelitë, e cila po detyron shumë të krishterë të largohen.

"Imagjinoni një Betlehem pa të krishterë, - tha ai në një konferencë shtypi para Krishtlindjeve. - Të krishterët e gjithë botës duhet ta dinë këtë realitet. Nëse nuk do të ketë një zhvillim të shpejtë në rrugën e paqes, shumë nga ata do të largohen".

Nga rreth 40 mijë të krishterë që jetojnë në Betlehem dhe zonat rrotull, disa mijëra janë larguar që nga fillimi i trazirave në vitin 2000.

Eksodi i të krishterëve nga Betlehemi ka nisur dekada më parë, por është theksuar kohët e fundit. Tashmë qyteti ka një popullsi me shumicë myslimane.

Kalendari i Liturgjive Hyjnore, SHKURT 2005

2 Mërkurë + Paraqitja e Zotit Krisht në Tempull (Ipapandia).

3 E Enjte + Simeon
Perëndipritësi. Pr/sha Ana.
Nikolla i Japonisë.

5 E Shtunë + Dëshg. Agathia.
Poliefkti i Kon/pojës. Osh.
Theodhosi.

6 E DIEL + 16 MATEUT.
Foti i Madh i Kon/pojës.
Varsanufi i Madh.

8 E Martë + Dëshm. Theodor
Stratilati. Profeti Zaharia.

10 E Enjte + Hierod. Harallambi.
Osh. Zinon postieri. Ana suedeza.
11 E Premte + Hierod. Vlasi.
Mbret/sha Theodhora.

12 E Shtunë + Meleti i Antiokisë.
Dësh. i ri Kristo kopshtari.

13 E DIEL + 17 MATEUT. Osh.
Martiniani. Ap. Akila e Priskila nga
të 70.

19 E Shtunë + Ap. Arkipi, Filimoni,
Apfia nga të 70. Dëshg. e re Filothea.

20 E DIEL + E
TAGRAMBLEDHËSIT E FARI-
SEUT. Leoni i Katanjës. (Triodhi)

23 E Mërkurë Hierod. Polikarpi i
Smirnës. Oshg. Gorgonia. (Hahen
të gjitha.)

24 E Enjte + Gjetja I dhe II e
kokës së Joan Pagëzorit.

25 E Premte Tarasi i Kon/pojës.
Hierod. Rigjini. Dësh. Aleksandri.
(Hahen të gjitha.)

26 E Shtunë + Fotinia samaritane.
Porfiri i Gazës. Dësh. Theoklit
magjistari.

27 E DIEL + E
PLANGPRISHËSIT. Omol.
Prokop dekapoliti.



NGJALLJA

Organ i Kishës Orthodhokse
Autoqefale të Shqipërisë

**Themelues: Kryepiskopi
Anastas**

**Del nën kujdesin e Këshillit
Botues**

Kryeredaktor: Thoma Dhima

**Adresa:
Kryepiskopata Orthodhokse,
Rruga e Kavajës, Nr. 151
Tiranë**

Tel: (042) 34-117, 35-095.

Fax: 32-109

**Shtypur në shtypshkronjën
"Ngjallja"**

Personalitete të vendit urojnë besimtarët orthodhoksë me rastin e festave

Presidenti i Republikës, Alfred Moisiu, u dërgoi një mesazh urimi besimtarëve të krishterë, ku thuhet: “Me rastin e Festës së Krishtlindjeve u uroj të gjithë besimtarëve të krishterë dhe familjeve shqiptare paqe e mbarësi. Në traditën e shkëlqyer të bashkëjetesës dhe harmonisë fetare në vendin tonë, Krishtlindjet festohen nga të gjithë shqiptarët dhe mesazhi i tyre është mirësia dhe dashuria mes njerëzve.

Shpresat që ngjall kjo festë e mbarë njerëzimit na inkurajojnë për të shtuar përpjekjet tona të përbashkëta për realizimin e dëshirave për një jetë më të mirë dhe të begatë. Shqiptarët meritojnë një të ardhme të sigurtë e të lumtur; kësaj i shërbejnë lutjet dhe urimet tona në këtë ditë të bekuar.

Në këtë ditë gëzimi dëshiroj t’ju uroj “Për shumë vjet Krishtlindjet!”.

Presidenti i Republikës, z. Alfred Moisiu, vizitoi në Ditën e Krishtlindjeve qytetin e Gjirokastrës. Ai mori pjesë në Liturgjinë Hyjnore festive në kishën “Metamorfoza e Shpëtimtarit”, pranë kalasë.

Pas meshës z. Moisiu i uroi besimtarët e pranishëm: “Uroj të gjithë të krishterët Gëzuar për shumë vjet Krishtlindjet! Kjo është një ditë e madhe që na fton të jetojmë në dashuri e mirëkuptim, të ndihmojmë njëri-tjetrin... Këto fjalë ne na kanë munguar për një kohë të gjatë, por u bë e mundur një gjë e tillë vetëm në kohën e demokracisë... Uroj besimtarët e Gjirokastrës, e këtij qyteti me vlera të rralla historike, kulturore, patriotike, arsimdashëse.”



25 dhjetor: Presidenti Moisiu duke marrë naborë në Kishën “Metamorfoza e Shpëtimtarit”, në Gjirokastrë



Kryeministri Fatos Nano, i shoqëruar nga bashkëshortja, ishte për Krishtlindje në qytetin e Korçës. Kryeministri bëri një vizitë në selinë e Mitropolisë së Korçës, ku u prit nga Hirësia e Tij Joani, klerikë etj.

Duke iu drejtuar të gjithë besimtarëve të krishterë të Korçës dhe të gjithë Shqipërisë, zoti Nano u shpreh: “Është një ditë e rilindjes, e shpresës, e gëzimit për të gjithë, është dita e konsolidimit të lirisë së besimit, të besimit tek Zoti dhe tek e ardhmja.

Roli i institucioneve fetare në ditë të tilla, që konsolidojnë institucionin kryesor të shqiptarëve, që është toleranca dhe harmonia midis njerëzve të besimeve të ndryshme, roli i këtyre institucioneve është i pazëvendësueshëm. Shteti është partner me to, duke i mbështetur në bazë të ligjit për rivendosjen e të gjitha të drejtave të cënuara nga historia apo nga regjime që shtypnin lirinë e besimit.

Më shumë se kurrë kemi nevojë për ditë të vërteta shprese”.

Kryeministri Nano me Hirësinë e Tij, Joanin

Kryetari i Partisë Demokratike, z. Sali Berisha, i shoqëruar edhe nga drejtues të tjerë të kësaj partie, ishte për urim në Kryepiskopatën e Hirshme, ku u prit nga Kryesekretari i Sinodit të Shenjtë, Protopresviter Jani Trebicka. Z. Berisha shprehu urimet për të gjithë besimtarët orthodhoksë shqiptarë për këtë ditë të madhe shprese dhe besimi, në një ditë kur më shumë se kurrë kemi nevojë për besim në të ardhmen. “Në një rast unik në të gjithë historinë këtu ndodhi një rilindje e vërtetë e besimit, një rilindje e

madhe dhe ju keni dhënë një ndihmesë shumë të madhe, sepse keni ndihmuar dhe keni kryer një veprimtari të jashtëzakonshme në kushte shumë të vështira... Është një dramë që dëgjoj që sot vidhet një kishë, nesër një tjetër dhe janë bërë disa njerëz pre e babëzisë për të fituar në objektet e kultit, të cilat janë vlera kulturore të paçmuara për të gjithë shoqërinë dhe për të gjithë besimtarët që besojnë tek Zoti.”

Të nesërmen, dt. 26 dhjetor, z. Sali Berisha ishte për urim edhe në Mitropolinë e Korçës.



Z. Berisha me Protopresviter Jani Trebicka